

## RAPORT

### **i Grupit *ad hoc* të Vlerësimit të Jashtëm për Akreditimin e pjesshëm institucional të Kolegjit Universitar “I Biznesit” (KUB).**

#### **I. Plani i takimeve të grupit “ad-hoc”**

GVJ i ngritur nga BA kreu vizitën pranë KUB më datë 15 Korrik 2020 dhe i realizoi të gjitha takimet e parashikuara sipas planit të miratuar nga ASCAL dhe KUB.

Draft-Raporti u dërgua në institucion me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare më datë 10.09.2020. Institucioni ka sjellë komentet mbi Draft-Raportin më datë 16.09.2020.

Grupi *ad hoc* i vlerësimit të jashtëm pasi u njoh me komentet e institucionit, sqaron si mëposhtë:

Për pikën 2: Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm, vazhdon ti mbetet qëndrimit të tij fillestar se Statuti i KUB duhet të përditësohet dhe në të të përfshihet dhe KSLP, fakt të cilin e konfirmon dhe vete IAL.

Për pikën 3: Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm bën konstatimin e gjëndjes së IAL në momentin e vizitës dhe gjatë kësaj vizite u konstatua mungësë në stafin akademik.

#### **II. Dokumentet në dispozicion të grupit “ad-hoc”**

Dokumentet u vunë në dispozicion të GVJ nëpërmjet sistemit AMS. Gjithsej në fazën e parë u vunë në dispozicion një sërë dokumentesh:

1. Vendimi i Bordit për Akreditimin Institucional Nr. 100, datë 10.11.2017
2. Miratimi i Statutit të Kolegjit Universitar të Biznesit UMASR Nr. 39, datë 30.01.2019
3. UMASR Nr. 139, datë 23.03.2018 për hapjen e njësisë kryesore "Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale"
4. Shkresa e aplikimit nga Institucioni për akreditimin e pjesshëm institucional.
5. Shkresa drejtuar BA mbi vlerësimin e njësisë kryesore të re (KSLP)
6. Strategjia e zhvillimit të KUB
7. Statuti i KUB
8. Rregullore e brendshme e KUB
9. Rregullore e brendshme e KSLP
10. Struktura organizative
11. Udhëzim mbi politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik
12. Stafit akademik KUB
13. Listë e stafit që kanë përfituar bursë Erasmus+
14. Listë e stafit të përfshirë në projekte kërkimore-zhvillimore
15. Listë e stafit të mbështetur financiarisht për botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore etj.
16. Planimetritë kontratat etj.
17. Lejet Higjienosanitare, Certificate për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi
18. Rregullore protokoll arkiva
19. Website
20. Vendime të Senatit Akademik
21. Model kontrate pune
22. Listë aktiviteteve dhe eventesh me dhe për studentët

23. Listë e Studentëve të punësuar në KUB, etj.

### **III. Gjendja e infrastrukturës së KUB**

Institucioni aktualisht nuk ka në zotërim pasuri të paluajtshme. Aktualisht aktivitetin e tij ai e zhvillon në dy godina për të cilat zotëron kontrata afatgjata të përdorimit si dhe po punon që në planin perspektiv të ndërtojë kampusin e tij universitar, projekt ky për zhvillimin e ardhshëm dhe pjesë e strategjisë 2021-2026.

Mbështetur në raportet e kontrollit të MASR dhe kontratat, planimetritë dhe dokumentacionin përkatës ligjor të vendosur në dispozicion nga institucioni, rezulton se KUB plotëson kriteret ligjore infrastrukturore për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

### **IV. Organizimi dhe autoritetet akademike të KUB**

Kolegji Universitar "I Biznesit", është licencuar me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 me emërtimin Akademia Profesionale e Biznesit. Është akredituar me Urdhër Nr. 557, datë 16.11.2012 dhe ri akredituar me VBA Nr. 100, datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afat vlefshmërie 10.11.2021.

Në strukturën e tij KUB është i organizuar në 3 njësi kryesore,

1. Fakulteti i Ekonomisë
  - Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit
  - Departamenti i Menaxhimit
  - Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës
2. Fakulteti i Drejtësisë.
  - Departamenti i së Drejtës Civile
  - Departamenti i së Drejtës Penale
  - Departamenti i së Drejtës Publike
3. Kolegji i studimeve të Larta profesionale
  - Studime të Larta Administrative
  - Studime të Larta Teknike

KUB ka Senatin Akademik, Bordin e Administrimit si edhe organet e tjera kolegjiale drejtuese si më poshtë:

a. **Organet drejtuese Kolegjiale vendimmarrëse në KUB janë:**

Senati - organi më i lartë vendimmarrës akademik. Ka në përbërje 7 anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësuesi i këshillit studentor

Asambleja e personelit akademik – organ vendimmarrës për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme.

Komisionet e përhershme – organe kolegjiale vendimmarrëse për ruajtjen e standardeve të cilësisë së procesit mësimor

b. **Organet drejtuese kolegjiale**

Rektorati është organ kolegjial ekzekutiv i KUB-it. Në përbërjen e tij janë: Rektori, Dekanët e Fakulteteve, Drejtori i KSLP dhe Administratori.

Dekanati – organ kolegjial që drejtohet nga Dekani. Përbehet nga Dekani dhe drejtuesit e njëjësive bazë/departamentet.

Këshilli i etikës – organ kolegjial i cili shqyrton e merr vendime për çështje që parashtrihen nga personeli akademik e jo akademik si dhe nga studentët

### c. Autoritetet drejtuese

Rektori,  
Drejtuesi i njësisë kryesore, Dekani/Drejtori  
Drejtuesi i njësisë bazë.

Drejtimi i institucionit ndjek një metodologji konsultative, mbështetur edhe në ligj, ku propozimet bëhen në nivel departamenti: për shembull, buxhetet e propozuara për departamentet merren parasysh gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor, përpara se të miratohen nga Senati Akademik dhe në fund, nga Bordi i Administrimit. Rrjedha e informacionit nga stafi në Senat, nëpërmjet departamenteve, dhe qarkullimi i vendimeve të marra nga Senati drejt stafit dhe studentëve është e efektshme. Menaxhimi dhe administrimi i institucionit dhe proceset vendimmarrëse parashikohen në mënyrë të përshtatshme për të qenë të kuptueshme nga stafi i të gjitha niveleve. [Ev: Statuti, Rregullore e Brendshme, Listë e stafit akademik dhe administrativ, RVB]

Mbledhjet e Senatit Akademik, Bordit të Administrimit dhe departamenteve, realizohen në mënyrë periodike dhe përfshijnë një axhendë dhe shkresa mbështetëse. Rolet dhe përgjegjësit e stafit kyç në institucion, për shembull të Dekanëve dhe Përgjegjësve të departamenteve, përcaktohen në Statut. [Ev: Statuti, Rregullore e Brendshme]

Institucioni sigurohet që të respektohen kufijtë e autonomisë së tij dhe që ta ushtrojë autonominë e tij brenda kufizimeve të legjislacionit. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë verifikon administrimin e institucionit dhe veprimtaritë e tij dhe është përgjegjës për përmbushjen e Standardeve Shtetërore të Cilësisë në nivel institucional. [Ev: Statuti, Rregullore e Brendshme, Organigrama]

### V. Krijimi dhe riorganizimi i njësisë së re kryesore në KUB

Kolegji Universitar "I Biznesit" (KUB), me datë 22.10.2019 ka aplikuar për akreditimin e pjesshëm institucional, duke kërkuar vlerësimin e njësisë kryesore "Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale".

Njësia kryesore "Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale", është hapur me Urdhër të MASR Nr. 139, datë 23.03.2018, pasi institucioni ka kaluar fazën e vlerësimit institucional dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 100, datë 10.11.2017.

KUB u zgjerua me njësinë kryesore të re, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale (KSLP), me urdhër të MASR Nr. 139 "Për hapjen e njësisë kryesore", si pjesë e strategjisë së zhvillimit të tij institucional. Licencimi dhe realizimi me sukses i dy programeve përkatëse të studimeve të larta profesionale pranë kësaj njësie kryesore, për KUB dikton përmbushjen e dy kërkesave themelore;

- E para ruajtjen e standardeve të arritura në akreditimin institucional dhe të programeve të akredituara në të dy ciklet e studimit.
- E dyta respektimi i kërkesës ligjore, për të mos lëshuar diplomë të pa akredituar nga ky institucion i arsimit të lartë.

Tashmë institucioni organizohet për të garantuar efektshmërinë e menaxhimit, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. Siç pasqyrohet edhe në organigramë, institucioni përbëhet nga 3 njësi kryesore, 2 fakultete dhe 1 Kolegji profesional, të cilat janë të organizuara në 8 departamente.

- Fakultetin e Ekonomisë,
- Fakultetin e Drejtësisë
- Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale

**Fakulteti i Ekonomisë** përbëhet nga:

- Departamenti Financë dhe Kontabilitetit;
- Departamenti i Menaxhimit;
- Departamenti Ekonomiksit dhe Informatikës.

**Fakulteti i Drejtësisë** përbëhet nga:

- Departamenti e Drejtë Publike;
- Departamenti e Drejtë Civile;
- Departamenti e Drejtë Penale.

**Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale** përbëhet nga:

- Departamenti i studimeve të larta administrative
  - Dp. Asistent Administrativ me profilet: Asistent i lartë administrativ; Asistent i lartë ligjor; Asistent i lartë kontabël.
- Departamenti i studimeve të larta teknike
  - Dp. Teknik i lartë, me profilet: Sisteme kompjuterike; Sisteme elektrike; Sisteme Motorike.

Kjo strukturë siguron ndarjen e funksioneve akademike dhe administrative. Statuti përcakton marrëdhënien ndërmjet strukturave institucionale, duke përfshirë autonominë e secilit subjekt dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi. Kjo strukturë përputhet me kërkesat ligjore dhe përmbush standardet ligjore lidhur me stafin dhe studentët, kapacitetin dhe infrastrukturën institucionale dhe kualifikimet e stafit. Institucioni ka autonomi të plotë dhe liri akademike në mësimdhënie dhe kërkimin akademik, në përputhje me Statutin të tij. Kjo përfshin liri për të përzgjedhur stafin e tij, për të ofruar programe studimi, për të krijuar lidhje bashkëpunuese me universitete dhe kolegje të tjera, për të pranuar studentë dhe për të menaxhuar burimet në pronësi të ligjshme të institucionit. Struktura institucionale organizohet në njësi mësimdhënie dhe kërkimi, që mbështeten nga organet administrative. Në Statut përcaktohen edhe rolet e Bordit të Administrimit, Senatit Akademik, Komisioneve të Përhershme, Këshillit të Etikës, Këshillit të Sigurimit të Cilësisë, Rektorit, Administratorit, dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion *GVJ konstatoi se në Statutin aktual të KUB nuk ka informacion lidhur me njësinë e re kryesore, KSLP. GVJ rekomandon që kjo përbën një dobësi dhe duhet reflektuar nga IAL.*

*Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale aktualisht drejtohet nga staf akademik me titull "Doktor". Sipas VKM nr.370 dt. 24.04.2017, ai duhet të jetë nga kategoria "Profesor".*

**[Ev: Statuti, Organigrama, Listë e stafit akademik dhe administrativ, Kualifikimet dhe kontratat e punës të stafit, Kontratat e qerasë, Takimi në IAL]**

**Koment:**

- Sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, neni 23 pika 2, në përbërje të Fakultetit (njësisë kryesore duhet të jenë 3 njësi bazë, nga të cilat në minimum 2 duhet të jenë Departamente. Kështu që ky kriter plotësohet.
- Përbërja dhe emërtimi i Departamenteve është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, si dhe me fushat e studimit dhe veprimtarinë akademike që ofrojnë. Ky kriter plotësohet.

**V.1.2. Përbërja dhe kualifikimi i personelit akademik sipas departamenteve**

- **Departamenti Financës dhe Kontabilitetit;**

*Lupita Kaxhori*

*Adriano Skaper*

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **8 pedagogë**, prej të cilëve:

- 2 kategoria Profesor
- 2 kategoria Doktor
- 4 kategoria Asistent

- **Departamenti i Menaxhimit;**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 4 kategoria Doktor
- 3 kategoria Asistent

- **Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës.**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 3 kategoria Doktor
- 4 kategoria Asistent

- **Departamenti e Drejtë Publike.**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 2 kategoria Profesor
- 1 kategoria Doktor
- 4 kategoria Asistent

- **Departamenti e Drejtë Civile.**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 3 kategoria Doktor
- 4 kategoria Asistent

- **Departamenti e Drejtë Penale.**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 1 kategoria Profesor
- 3 kategoria Doktor
- 3 kategoria Asistent

- **Departamenti i Studimeve të Larta Administrative.**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **5 pedagogë**:

- 2 kategoria Doktor
- 3 kategoria Asistent

- **Departamenti i Studimeve të Larta Administrative.**

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **5 pedagogë**:

- 1 kategoria Profesor
- 4 kategoria Asistent

**Koment:**

*Lujta Minxhoni*

*Uro Kape*

- Lidhur me numrin e personelit me kohë të plotë (PAE) të një departamenti brenda njësisë kryesore, sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, duhet të jenë minimum me 7 anëtarë me kohë të plotë. Ky kriter plotësohet për gjashtë nga departamentet.
- Njësia kryesore e re e krijuar, Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale, në përputhje me VKM nr. 370, 26.04.2017, secili nga departamentet ka nga 5 anëtarë me kohë të plotë në përbërjen e tij. Ndërkohë që mbështetur përsëri në këtë VKM, për programet 2 vjeçare me 120 ECTS, duhet që të paktën 2 nga stafi akademik të jenë me gradë shkencore apo titull akademik për çdo departament. Në momentin e aplikimit për akreditim, KSLP i përmbushte këto kërkesa ligjore për stafin akademik, ndërkohë që bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentacionin shtesë të kërkuar gjatë vizitës, rezultoi se në njërin prej departamenteve, atë të Studimeve të Larta Teknike, është vetëm 1 staf akademik me kohë të plotë në kategorinë Profesor. Megjithatë në këtë departament janë të angazhuar gjithsej (me kohë të plotë dhe të pjesshme) 2 staf i kategorisë Profesor dhe 4 të kategorisë Doktor.

## **VI. Programet e Studimit**

Në përputhje me misionin e tij, KUB ofron 12 programe studimi, 10 prej të cilëve janë të akredituar dhe tre në proces akreditimi. Programet e akredituara zhvillohen në ciklin e parë dhe të dytë, në Fakultetin e Ekonomisë gjithsej 6 programe, në Fakultetin e Drejtësisë 4 programe. Në Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale ofrohen dy programe studimi të cilët janë në proces akreditimi.

Programet e studimit janë në mbështetje të misionit të KUB duke ofruar kryesisht programe studimi në fushën e biznesit. Edhe katër programet e drejtësisë kanë orientim të specifikuar në përgatitjen e specialisteve dhe eksperteve të ardhshëm në përmbajtjen dhe natyrën e veçantë që ka sistemi legjislativ dhe ai kriminal në fushën ekonomike. Kështu për nga emri, programi “E drejtë biznesi” në ciklin e parë dhe “E drejtë civile dhe tregtare” në ciklin e dytë përfaqësojnë drejtpërdrejtë biznesin, por edhe programi në Bachelor, “Drejtësi” dhe në Master i Shkencave, “E drejtë penale”, duke u trajtuar në shume lënde bashkërisht me dy programet e tjerë.

Të gjithë programet janë të fokusuar në zberthimin e misionit të KUB dhe e gjithë infrastruktura e KUB është e lidhur me natyrën e programit. Veçanërisht KSLP, ka një infrastrukturë të preکشme dhe funksionale sipas programeve të studimeve të larta profesionale. Godina ku është instaluar njësia kryesore ka laboratorë shumë funksional për sistemet motorike, elektrike dhe elektronike.

Laboratorët e KSLP i shërbejnë drejtpërdrejtë programeve përkatëse për sistemet elektrike, motorike e kompjuterike, ashtu sikundër laboratorët e informatikës të dedikuar dhe të pajisura me kompjuterë mundësojnë zhvillimin dhe mbulimin e moduleve me karakter praktik të tilla si: Hyrje në Informatikë, Kontabilitet Financiar, Kontabilitet i Aplikuar, Statistikë I dhe II, Analiza e pasqyrave Financiare, ekonometri, etj. Sipas fushës dhe programit të studimit, studenti orientohet dhe këshillohet për të realizuar praktikat mësimore në fusha dhe veprimtari specifike sipas çdo programi studimi.

### **Koment:**

- Titujt e programeve të studimit të paraqitura janë në përputhje me kurrikulën që zhvillohet.
- Zhvillimi i programeve të studimit është në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, në përgjigje të tregut të punës dhe studentët ndiqen deri pas diplomimit, në punësim e më tej.

### **Përmbledhje**

- Kolegji Universitar i Biznesit (KUB), ka marrë akreditimin institucional për një periudhë 4 vjeçare, me vendim nr. 100, datë 10.11.2017.

- Me urdhrin nr. 139, datë 23.03.2018, “Për hapjen e njësisë kryesore Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale në KUB”, është hapur njësia kryesore KSLP pranë KUB.
- Në datë 22.10.2019, KUB ka bërë aplikimin për akreditim të pjesshëm institucional të njësisë kryesore Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale.

**Rekomandime:**

1. Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB) ka Statutin e tij të miratuar sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se në Statutin e KUB nuk i referohet në asnjë moment njësisë së re kryesore, Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale. GVJ rekomandon se Statuti i KUB duhet të përditësohet dhe në të përfshihet edhe njësia e re e krijuar.
2. Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të jashtëm konstaton se KUB nuk ka numrin e nevojshëm të stafit akademik me tituj shkencorë në njësisë kryesore, KSLP, sipas VKM nr.370 dt. 24.04.2017, dhe rekomandon që KUB duhet të punojë drejt përmirësimit në këtë drejtim.
3. Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të jashtëm konstaton se Drejtori i Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale nuk është nga kategoria “Profesor”, sipas VKM nr.370 dt. 24.04.2017 dhe rekomandon që kjo gjë të ndryshohet.

**Grupi ad hoc i Vlerësimit të Jashtëm**

**Prof. Dr. Luljeta Minxhozi**

**Prof. Dr. Ana Kapaj (Mane)**